



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.07.2018, ora 16:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit.
2. Shqyrtimi i projektligjit "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar"" (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Florjon Mima, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Tatiana Nurçe, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Robert Bitri, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Eglantina Gjermani, Dritan Bici, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Mirela Kumbaro - Ministre e Kulturës

Oltjon Muzaka - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës

Edmond Ahmeti - Drejtor në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve

Elira Kokona - Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë

Adrian Shega - Drejtor i Përgjithshëm e Kodifikimit dhe Hartimit të Legjislacionit

Fatmir Hoxhaj - Drejtor i Administrimit të Pronës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ergys Qirici - Drejtor i Përgjithshëm i Pronës Publike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Stefan Kocollari - p/sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arbjan Mazniku - Zëvendëskryetar i Bashkisë së Tiranës

Alban Dokushi - Drejtor i Përgjithshëm Juridik në Bashkinë e Tiranës

Agron Hysenlliu – drejtor i Institutit Shtetëror të Ndërtimit

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përsëndetje, kolegë deputetë!

Në vijim të axhendës së ditës së sotme, siç e theksuam edhe në mbledhjen e parades, sot do të fillojmë shqyrtimin e projektligjit "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar".

Debati ka qenë publik. Jemi njohur pak a shumë me qëndrimet pro dhe kundër kësaj iniciative. Besoj se të gjithë ju jeni familjarizuar me diskutimet e zjarra, pasionante dhe me argumentet e parashtruara. Kemi ndjekur nëpërmjet medias edhe komisionet e tjera. Ne jemi komision përgjegjës.

Kemi planifikuar një mbledhje sot, jo rastësisht në orën 16:00, për t'u dhënë mundësi të shprehën komisionet e tjera. Gjithsesi, nuk e kemi ende opinionin zyrtar të komisioneve të tjera, gjë që do të thotë se nesër do të vijojmë diskutimin nën për nën edhe me grupet e interesit. Pra, kemi parashikuar 2 mbledhje.

Sugjerimi i sotëm është që për shkak të debatit intensiv, argumenteve të njohura, sot të kalojmë direkt te pyetjet, për të kursyer kohën që kemi në dispozicion.

Pra, të kalojmë me pyetjet dhe përgjigjet e tyre, ta votojmë në parim, për t'ia lënë shqyrtimin nën për nën ditës së nesërme. Për ditën e nesërme ka një numër kërkesash të ardhur për dëgjesa, ka arkitektë individualë, shoqata etj.

Ne po administrojmë kërkesat. Nëse ndonjëri prej jush ka ndonjë koment, vërejtje për të bërë për mbledhjen e ditës së nesërme, apo ndonjë zë që doni të dëgjohet në komision, jeni më se të mirëpritur. Mund ta depozitoni kërkesën te sekretaria e komisionit.

Përfitoj nga rasti t'ju bëj me dije si deputet i Pogradecit, se këto ditë (2-7 korrik), po zhvillohet në Pogradec Festivali Ballkanik i Filmit. Jemi më shumë se të mirëpritur. Ka një juri ndërkombëtare dhe aktorë të njohur. Do të ftoja secilin prej jush (e di që nesër kemi komision, por ndoshta të mërkurën dhe të premten). Ditën e shtunë ndahen çmimet. Juria është ndërkombëtare. Është një event, që organizohet për të tetin vit radhazi në qytetin e Pogradecit, në të cilin unë jam deputet.

Të them të drejtën mezi po pres të shkoj sot tek Turbina, se e kemi pasur ëndërr ta shohim në funksionim atë godinë të amortizuar, që tani është kthyer në teatër. Madje mund të bëjmë edhe ndonjë shfaqje atje.

Faleminderit!

Jeni dakord që të kalojmë direkt te pyetjet?

Relator i këtij projektligji është zoti Ilir Beqaj. Ai i ka hyrë me thellësi çështjeve, me sa kam dijeni.

Propozimi im ka të bëjë me faktin që për shkak të prezantimit dhe argumenteve dhe debateve publike që janë bërë, jemi familjarizuar të gjithë dhe që ta shfrytëzojmë sa më mirë kohën, se kemi plot punë për të bërë, të kalojmë direkt te pyetjet dhe përgjigjet e tyre.

Dakord.

I uroj mirëseardhjen zonjës ministre të Kulturës!

Sot kemi një numër të konsideruar të ftuarish: Elira Kokona, Adrian Shega, Fatmir Hoxhaj, Stefan Kocollari, Oltjon Muzaka, Edmond Ahmeti, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, të Bashkisë së Tiranës, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Meqenëse çështja është komplekse, përfshin një numër të caktuar ekspertësh dhe specialistësh, gjykuam se ishte e nevojshme t'i ftonim.

Meqenëse biem dakord, do të kalojmë direkt te pjesa e pyetjeve. Unë do të administroj pyetjet. Të ngrejë dorën kush ka pyetje për të bërë!

Urdhëroni, zoti Bitri!

Më pas zoti Mima dhe zoti Beqaj.

Robert Bitri – Pyetja ime është më shumë për të marrë njohuri. Ky projektligj analizon vetëm sipërfaqen e teatrit apo qeveria shqiptare mendon për zhvillimin e tërë zonës?

E dyta, kam dëgjuar nga të gjithë edhe nga marrëveshja që kryetari i Bashkisë dhe ministrja bënë me artistët, që pjesa e Teatrit do të jetë në dispozicion të teatrit të ri dhe nuk do të preket. A është e vërtetë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Zëvendëskryetari i komisionit sugjeron të jepen përgjigjet mbas çdo pyetjeje. Tradita është që të bëhen pyetjet në fillim. Megjithatë, e marrim në konsideratë propozimin e opozitës.

Mirela Kumbaro – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj, të nderuar deputetë!

Po i përgjigjem menjëherë pyetjes së bërë nga zoti Bitri. Pyetja juaj është, nëse projektligji analizon vetëm sipërfaqen e Teatrit apo jo. Në fakt, ky projektligj nuk analizon asnjë sipërfaqe. Projektligji e ka të përcaktuar qartë objektin dhe qëllimin e vet. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar. Pra, është një ligj, i cili përcakton një procedurë, ngre një komision, i jep kompetenca dhe tagra këtij komisioni dhe vendos (meqë nuk jam juriste ndoshta më lejohet të përdor një shprehje jo juridike) vijat e kuqe, të cilat janë taksative dhe të dakordësuara tashmë gjatë konsultimeve publike.

Po i përgjigjem edhe pyetjes suaj të dytë, në lidhje me sipërfaqen e Teatrit Kombëtar. Në nenin 4, paragrafi i dytë i këtij projektligji, cilësohet: “Sipërfaqja që përbën pronën e Teatrit Kombëtar do të jetë po ajo edhe pas përfundimit të ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar.” Referuar dokumentit të Zyrës së Hipotekës është 5522 m² truall dhe 1260 m² ndërtesë, do të mbetet e njëjtë edhe pas përfundimit të ndërtimit të objektit, i cili do të vijë si rezultat i kontratës, e cila do të vijë si rezultat i negociatës që do të bëhet në kuadër të këtij ligji, nëse kjo negociatë do të rezultojë e suksesshme.

Eduard Shalsi – Kishit diçka, zoti Bitri?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirela Kumbaro – Është një procedurë, e cila i jep të drejtën një komisioni, ku nuk është vetëm qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ta mbaroj përgjigjen, zoti Bitri!

Faleminderit!

Brenda këtij komisioni janë përfaqësues të ndryshëm të institucioneve të pushtetit qendror, janë gjithashtu, edhe dy përfaqësues të komunitetit të aktorëve, të cilët do të jenë pjesë e

komisionit. Jo vetëm kaq, por komisioni ka të drejtë të thërrasë edhe ekspertë të jashtëm, në rast se gjykohet e nevojshme. Gjithashtu, ky komision do të drejtohet nga Bashkia e Tiranës.

Eduard Shalsi – Urdhëroni, zoti Mima!

Florion Mima – Zonja Ministre,

Ju kam ndjekur gjatë gjithë ditës në komisione të ndryshme.

Edhe në sintezë të atyre që dëgjova gjatë dy takimeve të mëparshme, më lejoni t’ju them se në muajin shkurt keni deklaruar me përgjegjësi para kamerave, por edhe në *broadcast* privat, se Teatri nuk prishet. Keni thënë se flisni me përgjegjësi (nuk po ju citoj, sepse nuk e kam tani materialin), “Nuk prishet!” dhe “Në atë territor nuk do të ketë kulla”. Këtë keni thënë në shkurt.

Ndërkohë, Kryeministri në muajin mars ka thënë se do të prishet dhe nuk e luan topi.

Unë gjykoj se historia e prishjes është shumë më e hershme.

Nuk e di, nëse e mbani mend një personazh (Meke quhej), që flinte te krevati i perandorit, në pallatin e mbretit, me opingat gjithë baltë dhe hipi kastile aty që ta bënte me baltë mbulesën e mëndafshit, nga urrejtja, sepse po flinte në krevatin e një të kamuri. Pastaj shkoi në tualet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ju lutem, zoti Beqaj!

Kur të marrësh fjalën më pas, shprehu!

Florion Mima – Pastaj hodhi në hale (më falni për shprehjen), të gjitha serviset e argjendta dhe kur pa bidenë, iu duk si tavolinë dhe u ul, të hajë aty.

Ky farë personazhi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjo!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky personazh u bë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vazhdo ti dhe po pushoj unë.

Eduard Shalsi – Ju tërheq vërejtjen!

Ju lutem, zoti Beqaj! Mos e ndërprit!

Florion Mima – Ky personazh u bë drejtor në një nga drejtoritë e Sigurimit të Shtetit. Në vitin 1958 ka bërë një shkresë, ku thotë se Teatri duhet të prishet, me të njëjtat argumente që keni listuar edhe ju: është prej pupuriti, është me eternit, është ndërtesë fashiste, është konceptuar për të argëtuar italianët. Kjo, që në vitin 1958. Ju nuk kishit lindur atëherë dhe nuk kishit nga ta dinit.

Më pas, një personazh i ngjashëm me të në vitin 2002, tha se do ta prishë. Kur aktorët përpiqeshin t'i shpjegonin se ky teatër ishte një pjesë e jetës së tyre, e memories sonë historike dhe kulturore, ai i kundërshtonte duke u thënë: “Çfarë do të varni ju këtu, brekët e Violeta Manushit? Jo.”

Tani, në vitin 2018, ju po na thoni një herë se nuk do ta prishni (në shkurt), dhe një herë se do ta prishni, do ta rrafshoni (në mars).

Ky ishte parashtrimi që desha të bëj, për të kaluar te pyetje-përgjigjet e shkurtra, sepse edhe unë do t'i ndërtoj në mënyrë të atillë. Po të kishte fonde shteti shqiptar, a do ta kishte bërë vetë këtë Teatër dhe nuk do t'i kishte lënë privatët të fusnin hundët? Po, apo jo?

Eduard Shalsi – Një sekondë! Do të vijojmë me pyetje-përgjigje?

Florion Mima – Po.

Eduard Shalsi – Ju lutem, sa më koncize!

Florion Mima – Edhe një herë, po të kishte fonde, po të kishte mundësi financiare shteti shqiptar, a do ta kishte, a do ta kishte bërë vetë Teatrin?

(Flet pa mikrofon)

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

E para, duke iu referuar citimeve që më bëtë, sigurisht është gjithmonë shumë e lehtë të citosh dhe t'i nxjerrësh nga konteksti disa deklarata dhe pastaj t'i përdorësh ato për konsum politik. Ju mirëkuptoj për këtë gjë nga ju, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk ju ndërpreva, zoti Mima!

Eduard Shalsi – Të lutem!

A ka mundësi një sekondë, që të biem dakord për një gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju bëtë disa komente dhe thatë se çfarë kishte thënë. Minimalisht...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Ju lutem, se e kemi respektuar njëri-tjetrin!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Ju lutem, se e kemi respektuar njëri-tjetrin në këtë komision!

Thatë disa gjëra. Rezervoni të drejtën, meqenëse vure...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se nëse më akuzon që kam thënë diçka, ndërkohë që unë nuk e kam thënë, është e drejta ime...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, le të bëjë një komet shumë të shkurtër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta mbarojmë apo do të vazhdojmë si ato historitë e tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le të bëjë një koment të shkurtër dhe më pas do të ketë përgjigje të shkurtra me po apo me jo. Të është dhënë mundësia, që të përgjigjet me po apo me jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

A ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pastaj do të hyjmë edhe në diskutime.

Zonja Kumbaro,

Mos e ndërprisni njëri-tjetrin, se pastaj na del situata jashtë kontrollit! Ta lëmë të mbarojë njëra palë së shprehuri dhe më pas, kanë mundësi të shprehen edhe të tjerët.

Mirela Kumbaro – Atëherë, për saktësi të gjithçkaje, më 14 shkurt kam thënë, në një debat televiziv mbas një debati të hapur prej kohësh me komunitetin e artistëve me një tjetër projektligj, i cili kishte të bënte me disa ndryshime në ligjin “Për artin dhe kulturën” dhe mbas disa deklarimeve të paktën prej 2 vjetësh, që kam bërë unë që në vitin 2014 kur kam nxjerrë në

pah situatën e rëndë në Teatrin Kombëtar dhe kur kemi filluar punën për ndërtimin e skenës së re, gjithmonë kemi thënë: në situatën e rëndë që ndodhet Teatri Kombëtar, duhet të transferohet deri në ndërtimin e një Teatri të ri Kombëtar. Një kërkesë e bërë prej dekadash nga komuniteti teatror në këtë institucion të ri me qëllim garantimin e performancës dhe jetës së aktorëve, të cilët i kemi mbajtur në limitet e mbijetesës, me ndërhyrjet që kemi bërë.

Ndërkohë, nuk kishte ardhur ende propozimi për projektin në fjalë. Sigurisht, unë kam thënë: “Për sa kohë nuk kemi një propozim tjetër, nuk do të vazhdojmë t’i mbajmë të gjitha sallat deri në gjetjen e një zgjidhjeje”. Kjo është ajo që kam thënë.

Kur ka ardhur një koncept i parë propozimi, kemi pjesën tjetër të historisë dhe kemi bërë publike çdo hap, qoftë vullnetet politike të Kryeministrit, timin si ministre e Kulturës, për të ndërtuar një teatër të ri, qoftë të gjithë procedurën që ka ndjekur për të gjetur rrugën ligjore për ta bërë të zbatueshëm këtë vizion.

Për të folur për prishjen, ajo nuk është objekt i këtij diskutimi. Objekt i këtij diskutimi është ndërtimi i një teatri të ri. Unë kështu do ta shikoja dhe kështu do t’ju ftoja ta shikonit.

Kur pyesni, nëse do të kishte fonde shteti shqiptar, ne e kemi treguar që me fondet që ne kemi pasur dhe kemi në këto 4 vjet, kemi bërë ndërhyrje dhe investime në skenat teatrore në të paktën 4 kantiere të tilla, të cilat nuk janë bërë në 25 vjet, sepse ndoshta nuk janë gjetur fondet për këtë punë, ose janë bërë si në rastin e Piramidës, ku u hodhën 6 milionë dollarë për të bërë një teatër atje, u la në mes, sepse doli një tjetër vendim, 3 milionë dollarë u gruposën aty dhe kështu vazhdoi ajo histori dhe ne nuk e morëm vesh se çfarë ndodhi.

Sigurisht, fondet publike që ne kemi pasur dhe kemi në dispozicion, e kemi treguar me shifra, që i kemi vënë rregullisht në shërbim të investimeve, qoftë me trashëgiminë kulturore, qoftë në skenat e teatrove. 4 kantiere teatrorë dhe 4 muze të rinj janë bërë me fonde publike.

Kjo nuk na pengon të kërkojmë pa fund dhe të mirëpresim dhe të gjykojmë dhe të shqyrtojmë çdo mundësi të re që hapet për t’i shtuar fondet publike me fonde që vijnë nga burime të treta. Me kusht që ato të jenë të ligjshme, transparente dhe të kontrollueshme.

Po kështu, kemi marrë fonde nga Fondacioni Amerikan për Zhvillim, me të cilin bashkuam forcat për të bërë muzeun “Marubi”. Po kështu kemi marrë fonde nga BE-ja, për rehabilitimin e plotë të parkut të Apolonisë. Po kështu bashkuam forcat me BB-në, e kështu me radhë.

Për çdo kontribut, gjithmonë e më shumë, kërkojmë që sektori privat të bëhet pjesë e investimeve për atë, që ne e quajmë pasuri kolektive. Këtë nuk e them vetëm unë. Jo më pak se 2 vjet më parë UNESCO shpalli thirrjen për të kërkuar dhe për të ftuar sektorin e madh multinacional privat, për të investuar dhe për të kontribuar në mbajtjen e trashëgimisë kulturore.

Eduard Shalsi - Zonja Kumbaro,

Përgjigja e pyetjes ishte: Nëse do të kishit para, do ta kishit ndërtuar vetë. Dakord? Për të qenë sa më konciz.

Mirela Kumbaro – Sigurisht, edhe e shpjegova.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Vazhdoni me pyetjen tjetër!

Florion Mima – Pra, nëse do të kishit para, do ta kishit ndërtuar vetë Teatrin.

Zonja Kumbaro,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos u shqetësoni nga kolegu Beqja!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi, se kemi ftuar ministren këtu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pse bën barsoleta kot tani!?

Ku keni kërkuar për fonde? Sigurisht, keni kërkuar në buxhet, sepse unë e kam përpara edhe programin 3-vjeçar. Aty nuk keni tavane.

Ku keni kërkuar për fonde, në një kohë kur Kuvendit i thoni se nuk keni para?

Ju, për shembull, keni trokitur te... Po apo jo? Të lutem! Shkurt fare.

Mirela Kumbaro – Shumë faleminderit!

Po, patjetër. Nëse doni t’ju ilustroj këtë gjë, mund t’ju them se në katër vjet, nga viti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, një sekondë, ta mbaroj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Po s’po jep përgjigjen pra! Lëre ta mbarojë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse thotë: kemi filluar që para katër vjetësh. Lëre ta mbarojë, pra!

Mirela Kumbaro – Në katër vjet kam kërkuar rregullisht fonde për disa objekte shumë të rëndësishme, përfshi Teatrin Kombëtar, përfshi Bibliotekën Kombëtare, përfshi Teatrin e Operas, përfshi Muzeun. Faktin që kemi arritur të ngremë jo pak fonde për disa objekte, që i quaj të së njëjtës rëndësi, mund t’jua provoj me shifra. Në katër vjet kemi ngritur 23 milionë euro për ndërhyrje kapitale në shumë objekte të trashëgimisë kulturore e të artit, dhe 19 milionë euro janë investuar nga buxheti i shtetit për kantiere, të cilat besoj se më japin mjaftueshëm arsye që, si ministre e Kulturës, të ndjehem krenare, por aspak e kënaqur, sepse nevojat janë shumë më të mëdha se sa fondet që kemi arritur të sigurojmë.

Kemi kërkuar edhe për teatrin Kombëtar, por nuk e kemi bërë të mundur këtë gjë nga donatorët ndërkombëtarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

29, po. Kërkojmë ndjesë!

Tani, pas tre komisionesh, po i hap edhe unë shifrat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ka problem, se pastaj do më thoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Florjon Mima – Por nuk ju kanë dhënë për teatrin. Keni një përgjigje, në mënyrë të grupuar ose nga donatorët kryesorë, me shkrim, ku ju refuzojnë ose shprehin pamundësinë për t’ju ndihmuar?

Mirela Kumbaro – Që të jem fare e saktë në lidhje me burimet dhe shumën e donatorëve, të hedhur në raporte me Ministrinë e Kulturës, është 121 milionë e 421 mijë euro. Ndërsa për Teatrin Kombëtar nuk e kemi me shkrim, ju e dini shumë mirë se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po më lini ta mbaroj përgjigjen tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Mima, unë kam respekt maksimal për ju!

Të gjitha, përpara se të mbërrihet në letra e në shkrime, sigurisht që ka një sërë bisedimesh që shkëmbehen, për të treguar se cili është projekti që ka interes për donatorët. Në

ato projekte që kanë pasur interes donatorët, kemi arritur. Aty ku s'ka pasur interes për donatorët, s'ka.

Faleminderit!

Florjon Mima – Me institucionet financiare ndërkombëtare, Banka Botërore, FMN-ja, bankat e tjera të zhvillimit, BERZH e të tjerë, që janë pak më larg donatorëve klasikë, a keni biseduar, që t'ju ndihmojnë për prezantimin e ndonjë instrumenti të ri financimi? Po ose jo.

Mirela Kumbaro – Në fakt, ne kemi një listë të hartuar, të cilën e përtërijmë rregullisht, të godinave prioritare; ose jo vetëm të godinave, por le të themi të projekteve prioritare, ku padyshim institucionet kombëtare marrin një rëndësi të veçantë, listë që ne e përditësojmë dhe ua paraqesim të gjithë donatorëve potencialë, të cilët përgjigjen për ato institucione apo pika, që ata i gjejnë me interes. Teatri Kombëtar, me sa duket nuk ka tërhequr vëmendje, ndërkohë që, për shembull, ka tërhequr vëmendje Gjirokastra, muzeu “Marubi? E kështu me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Ndize mikrofonin!

Florjon Mima – ... të projektit 1 miliard euro, e keni diskutuar ndonjëherë këtë çështje në qeveri? Në qoftë se mund t'i bësh *disclosure* ndonjë informacioni konfidencial. Po ose jo.

Mirela Kumbaro – Ka një sërë projektesh prioritare, që edhe ne si Ministri Kulture, i konsiderojmë prioritare, të cilat janë prezantuar. Nëse themi se ka një lloj gare mes projekteve, është më së shumti mbi bazën e një projekti konkret, projekt të cilin nuk e kemi të disponuar për Teatrin Kombëtar. Kjo për shkak të kompleksitetit që ka dhe të gjitha ekspertizave që kemi marrë lidhur me ekzistencën e asaj godine. Është shumë e vështirë të mbërrish në një projekt, i cili, nga pikëpamja teknike të meritojë të quhet projekt zbatimi, gjë që ende nuk e kemi.

Florjon Mima – Autori i projektit e ka bërë projektin me porosi nga ju? Kur them me porosi nga ju, domethënë: nga ekzekutivi, nga pushteti vendor apo nga firma fqinje?

Mirela Kumbaro – Propozimi i ardhur nga subjekti privat “Fusha sh. p. k.” mbart edhe përzgjedhjen e arkitektit dhe projekt-propozimin e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Florjon Mima – Pra, nuk është qeveria?

Mirela Kumbaro – Atëherë, e përsëris edhe një herë: projekti dhe autori, ose më saktë projekt-propozimi, se ende nuk kemi një projekt të plotë, por koncepti i projektit të propozuar

dhe emri i arkitektit ose i studios që e ka realizuar, është pjesë e propozimit të bërë nga subjekti “Fusha”.

Florjon Mima – I cili, edhe sipas infove që kemi marrë nga ju sot, është gjithë fqinj me tokën bashkiake e publike. Sa metra katrorë parcelë zotëron fqinji juaj?

Mirela Kumbaro – Atëherë, siç e theksova edhe në komisionin pararendës, ku ju ishit prezent, të gjithë elementët që kanë të bëjnë me analizën teknike, sipërfaqen, detajet teknike të projektit, çështjet e standardit, janë të përfshira në detyrat që do të ketë komisioni negociator, kompetencat e të cilit janë përcaktuar shumë qartë në projektligjin që propozohet. Nëse doni t’i përcaktojme e t’i detajojmë më qartë, është pikërisht atributi juaj, dhe ne do ta zbatojmë.

Florjon Mima – Ju sot nuk e dini se sa zotëron ai që është vetofruar për të zhvilluar të gjithë parcelën?

Mirela Kumbaro – Edhe një herë e theksoj: të gjitha këto detaje teknike nuk janë objekt i këtij projektligji që ne po propozojmë, por do të jenë objekt i gjithë punës që do të zhvillojë komisioni negociator, që i ka të përcaktuara shumë qartë çfarë dokumentacioni do të marrë, çfarë analize do të bëjë, dhe cilat janë fushat e kompetencës së tij.

Eduard Shalsi – Në shtesë të asaj që pyeti zoti Mima, unë shoh se bashkia e Tiranës ka paraqitur kërkesa. Pra, është iniciuar më datën 23 shkurt 2018. Këtu shoh se ka ardhur edhe nënkryetari i bashkisë. Në fakt, do të ishte me interes të dinim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të vazhdosh?

Meqë ishte komplementare me atë që pyete ti në lidhje me procedurën. Mirë. Më fal! E tërheq.

Atëherë, do ta vijojmë pastaj, sepse dua të sqarohem edhe vetë në lidhje me këtë çështje.

Florjon Mima – Po që se do të kisha marrë një përgjigje për pyetjen që sapo ju bëra, do të kisha vijuar me një pyetje tjetër, hipotetike gjithmonë. Nëse ju do të kishit kaluar në një garë, në një koncesion, ose PPP klasike, ku ai vetofruesi mund të kishte marrë edhe bonusin, por gjithsesi gara do të ishte bërë (kuptohet, në këtë rast skema klasike për shërbimin që merr popullata sot, do të ishte e tillë: ai do ta ndërtonte godinën nga e para, dhe do të vinte rojën atje te dera, që nëpërmjet biletave... por kuptohet, të tillë njerëz... të tillë njerëz gjen rrallë e më rrallë) nëse do të kishte garë, sa do të ishte përqindja që mund të kishte marrë i zoti i tokës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I zoti i tokës sot është bashkia plus populli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse e jep këtë tokë për ta zhvilluar, në mungesën e garës ai do të marrë një sipërfaqe X. Në rast se do të kishte garë, sa do të ishte ky X, sipas indiceve që ju keni nga tregu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, pra, më thuaj që nuk përgjigjem dot!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Beqo, të lutem! Të lutem tashti!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirela Kumbaro – Jo, unë nuk intimidohem nga askush, sepse e kam kaluar moshën e intimidimit. Thjesht po pres radhën për t’u përgjigjur.

Nëse e kuptova drejt, pyetja juaj ishte: çfarë do të ndodhte sikur teatri të jepej me koncesion?! Nuk e shtroj fare këtë pyetje, e për pasojë nuk i jap asnjë përgjigje, sepse nuk e shtroj në asnjë rast alternativën dhe skenarin që teatri të jepet me koncesion, për t’u shfrytëzuar e për t’u përdorur nga një palë e tretë, kushdoqoftë ajo. Teatri është pronë publike. Shfrytëzimi i tij bëhet nga institucionet publike. Sipas vizionit tim, teatri do të jetë sërish pronë publike, dhe do të shfrytëzohet nga institucionet publike.

Florjon Mima – Ju thashë pak a shumë këtë gjë: në qoftë se atje investohet, po themi një shumë X, afërsisht 200 milionë euro, pronari i tokës, nëse ka 50 % të të gjithë parcelës, do të marrë 50 % të vlerës. Ky 50 % i vlerës del nga gara, nga tregu. Këtë thashë. Sa do të ishte, nëse do të kishte garë, dhe sa është në kushtet e vetofrimit?

Mirela Kumbaro – Në fakt, detajet e tërë kësaj llogarie do të jenë pjesë e gjithë arsytimit që do të bëjnë anëtarët e komisionit negociator, kur t’u futen gjithë këtyre elementeve. Meqenëse këtu jam bashkë me nënkryetarin e bashkisë, që në fakt është institucioni kompetent për menaxhimin e territorit dhe për këtë lloj aspekti, mund t’ia lë përgjigjen, për të qenë më afër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arbjan Mazniku – Nëse mundet, për këtë pyetje.

Të paktën ende në nivelin e propozimit nga ana e kompanisë propozuese, pjesë publike në territor janë 8465,2 metra, që është pronë-shtet, me dimensione të ndryshme. Një pjesë prej 5522,7 është teatri, ndërsa pjesa tjetër është bashkia Tiranë, po prapë pronësi-shtet në sasi më të vogla.

Sidoqoftë, në projektligjin e propozuar para jush, propozimi është që pjesa prej 5522,7 metra e teatrit, të jetë një zonë që do të mbetet edhe në fund të procesit pjesë e teatrit. Kjo do të thotë se pjesa që futet realisht në zhvillim është një sipërfaqe, e cila është diferenca prej 2942,5 metra.

Pra, në thelb, shkëmbimi nuk ndodh midis 8465,2 metra, por ndodh midis 2942,5 metrave, në të cilat zotëria do të ndërtojë, përveç kësaj, edhe në truallin privat që ai zotëron; në këmbim të ndërtimit, ato metra që do të na takonin neve, jo për 8 mijë metrat po për 2900 metrat, ne nuk i marrim ndërtim si bashki, që jemi pronari më i madh në territor, por ato metra i marrim në këmbim, si sipërfaqe teatri. Nga 1200 metra që kemi sot ndërtim teatër në hipotekë, ne marrim 9 mijë metra teatër, që do të thotë; së pari ruajmë plotësisht 5522,7 metra truall, dhe nga 1200 metra teatër, një ndërtesë në gjendje të rrënuar, siç u shpreh deri tani, shkojmë në 9 mijë metra teatër.

Ky është shkëmbimi. Pavarësisht se në relacion është thënë se vlera totale e të gjithë aseteve që futen është 6 milionë euro, është shumë më pak se aq, sepse po të heqim 5522 metërshin, që në fakt siç futet del nga llogaria, vlera e vetme që futet në mënyrë të mirëfilltë dhe që këmbëhet është vetëm 2900 metra. Ne fitojmë më shumë se 30 milionë euro fond të investuar, pa futur asnjë qindarkë nga bashkia apo nga shteti.

Thelbi i kësaj logjike është: duke i marrë 2900 metrat me çmim reference, se ajo është tokë e lirë, pa ndërtesë mbi të, ne fusim më pak se 1 milion euro dhe marrim mbrapsht 30 milionë euro. Në secilin prej skenarëve të mundshëm, me çfarëdo llogarie, edhe me llogarinë e famshme të përqindjes së ndërtuesve, kjo është një marrëveshje shumë herë më përfituese për shtetin, të paktën në propozimin fillestar.

Sigurisht, kemi ende mundësinë të vazhdojmë të negociojmë, për të parë mundësinë të marrim atë që është më e mira për interesin publik.

Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Florjon Mima – Të gjitha shifrat që ju thatë sfidohen dhe bien lehtësisht poshtë. Sepse sot askush këtu nuk është në gjendje të japë një përgjigje në lidhje me godinat e reja që do të ndërtohen, të cilat kërkohet të jenë uniform me pjesën rreth e qark: a do të jenë tetëkatëshe, do të jenë dhjetëkatëshe, do të jenë njëzetegjashtëkatëshe apo do të jenë dyzetkatëshe, sa ç'është hoteli ngjitur me të?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është afërsisht 40 kate. Sa është?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dyzet po them unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, ç'rëndësi ka? Do ta çoni ju dyzet, të jesh i bindur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse kjo është gjuha tinëzare që përdoret. Do të jetë në uniformitet, por në uniformitet me kë? Keni ndonjë përgjigje për këtë? Me kë do të jetë në uniformitet?

Arbjan Mazniku – Atëherë, kjo ka dy elementë. Elementi i parë ka të bëjë me arsyen përse ndodhemi këtu. Ligji ekzistues ka synim të autorizojë një grup shtetëror, një komision shtetëror, për të qenë enti negociues midis shtetit shqiptar, në tërësinë e tij, që do të thotë qeveri qendrore dhe qeveri lokale, me një propozim nga një palë private.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se aty do të dal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Mima, e dëgjova pyetjen, dhe nuk ka nevojë ta dëgjoj dy herë për ta kuptuar. Më mirëkuptoni në lidhje me këtë. E dëgjova pyetjen, e kuptova, po ju jap përgjigjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Keni bërë një pyetje. Po ndiqet një logjikë shpjegimi, sepse pyetja jote është shumë e drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë, se ta jap unë fjalën.

Pyetja jote është shumë e drejtë. Brenda pyetjeve tuaja ka ca elemente, në lidhje me të cilat edhe unë do të doja të dëgjoja disa shpjegime. Pikërisht për këtë të fundit, do të më interesonte ta vijonte logjikën; pra, si keni ardhur deri këtu? Pse gjendemi në këtë pikë? Pse zgjidhja është kjo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë! Zoti Beqaj për procedurë. Pastaj zoti Bitri.

Për procedurë ama.

Ilir Beqaj – Ju lutem, zoti Shalsi: pyetje normale, të logjikshme, të ligjshme e të përligjura mund të kemi, por pyetjet e fundit që u shtruan janë pyetje që mund t'i kemi kur të na vijë kontrata për miratim. Ata po fillojnë negociatat. Sot jemi te negociatat. Kur të vijë kontrata do të ketë edhe se sa metra katrorë do të zhvillohen aty. As pyetjet e tjera të kësaj natyre nuk janë pjesë e thelbit të sotëm.

Eduard Shalsi – Në rregull!

Zoti Bitri, keni diçka tjetër? Po.

Robert Bitri – Tani, sipas procedurës që kemi ndjekur, gjithsecili i bën të tëra pyetjet tani, pyetje pas pyetjesh, pyetje pas pyetjesh; të gjitha pyetjet të drejtohen, e në fund fare t'i përgjigjen secilit nga ne. Se kështu, pyetje-përgjigje, pyetje-përgjigje, i bie të kapemi edhe për një fjalë.

Eduard Shalsi – Në dorë e kemi.

Robert Bitri – Unë mendoj se kështu e kemi si traditë.

Eduard Shalsi – Ne e kemi në dorë, kështu që kemi vendosur bashkërisht në lidhje me mënyrën se si do të procedojmë në komision. Kishte një sugjerim, që të bëheshin pyetjet e të merreshin përgjigjet. Tani ka një propozim tjetër, ndërkohë që të mundohemi të mbarojmë. Vetëm, ju lutem, mos ndërprisni njëri-tjetrin!

Florjon Mima – Zonja ministre, cila do të merret si pikë referuese: ndërtesa e hotelit të ri në krah apo ndërtesat e vjetra të kohës së Italisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Një sekondë! Për procedurë, një sekondë!

Ne kemi një panel aty. Paneli është i përbërë nga Ministria e Kulturës, e Ekonomisë, Bashkia. Ty të intereson individi që përgjigjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zoti Mima, ta them unë pastaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Proceduralisht, të intereson përgjigja e pyetjes, apo të intereson ta japë përgjigjen personi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani jemi në fazën e negocimit, pra të dhënies së dritës jeshile për negocim.

Mirela Kumbaro – Në fakt, të gjitha pyetjet tuaja kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me objektin e negociatës. Ky projektligj nuk ka këtë objekt. Kur të jetë gati kontrata, që është parashikuar në këtë projektligj, ne do të rikthehemi sërish në të gjitha komisionet e parashikuara parlamentare në Kuvend, për ta diskutuar, kundërshtuar apo për ta pranuar. Si të doni ju. Atëherë do të jetë momenti për t'i bërë të gjitha këto pyetje.

Nuk është Ministria e Kulturës dhe as ministri që e bën këtë. Në fakt, as ky projektligj nuk e ka në objektin e tij diskutimin në këto parametra. Ky projektligj i jep tagrin komisionit negociator dhe atëherë do t'i merrni të gjitha përgjigjet. Ne do t'i mbajmë shënim që tani të gjitha pyetjet, në mënyrë që ju t'i merrni përgjigjet në kohën e duhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju e morët një përgjigje, por ndoshta...

Eduard Shalsi - Zonja ministre, ju lutem!

Florion Mima – Vazhdojmë me një pyetje tjetër.

Ju thatë se kostoja e rinovimit, nëse ndërtesa do të rinovohej, ishte shumë më e lartë se çmimet minimale fiskale. A ju kam dëgjuar drejt?

Mirela Kumbaro – Nga ekspertiza që është bërë nga Instituti i Ndërtimit ne kemi një raport të detajuar, i cili është firmosur nga 12 inxhinierë dhe arkitektë. Këtu pranë meje kam drejtorin e Institutit të Ndërtimeve, i cili publikisht, por edhe me shkrim, ka shprehur se sado e lartë që të jetë një kosto dhe sado që të shpenzohet objekti është i parikuperueshëm.

Megjithatë, drejtori mund ta shprehë këtë gjë edhe në gjuhë teknike. Ndërkohë, nga ana tjetër, mund të ndaj me ju eksperiencën që ne kemi në këta 4 vjet, duke qenë se kemi hapur

tashmë 4 kantiere të tjerë teatrorë, ku kemi parë shumë projekte dhe jemi konsultuar me shumë ekspertë në përgatitjen e projekteve që janë në proces. Si për shembull Teatri i Operës dhe Baletit. Të gjitha objektet që ne kemi analizuar (unë mund t’ju jap edhe me shkrim disa shembuj), flasin për kosto rikonstruksioni dhe bëhet fjalë gjithmonë për shifra që shkojnë mbi 25 milionë, 35 milionë deri në 900 milionë euro. Sigurisht në proporcion me vendin, parametrat, standardet e të tjerë. Pra, bëhet fjalë për shifra shumë të larta. Arsyeja kryesore është, këtë e lidh me pyetjen që ju bëtë pak më parë, që edhe sikur t’i kishim të gjitha paratë e mundshme, këtu kemi raportin e Institutit të Ndërtimit që thotë: “Godina për shkak të teknologjisë që ka të shkallës së amortizimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atë mbase e njihni ju, se unë nuk e njoh, zoti Mima!

Unë në krah kam drejtorin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po flas për një gjë tjetër, që është raporti zyrtar i vitit 2018 i Institutit të Ndërtimit dhe i referohem vetëm atij. Në këtë raport thuhet pikërisht kjo që sapo pohova, por nëse doni një përgjigje më të drejtpërdrejtë, zoti drejtor është këtu dhe mund t’jua sqarojë.

Faleminderit!

Florjon Mima – Pyetja ime e fundit ka lidhje më atë që ngriti Berti dhe pjesërisht iu përgjigj kryetari i bashkisë. A mund të më konfirmoni këtu me “po” ose “jo”, që 5520 metrat, që sot i ka Teatri, do të jenë përsëri 100% në pronësi të Teatrit? Mos filloni të më thoni 9 mijë e ca metra, sepse...

Eduard Shalsi - Jepini mundësinë që të kthejë përgjigjen.

(Diskutime pa mikrofon.)

Mirela Kumbaro – Zoti Mima, përgjigjja ime është “po” dhe përgjigjja sipas ligjit është në nenin 4, paragrafi 2.

Eduard Shalsi - Shumë e qartë.

Mirela Kumbaro – Atëherë, që të jem e saktë me dokumentin e ZVRPP-së, sipërfaqja në zotërim është 5522,7 metra katrorë. Në nenin 4 thuhet: “Sipërfaqja që përbën pronën e Teatrit Kombëtar do të jetë po ajo edhe pas përfundimit të ndërtimit të Teatrit të ri Kombëtar”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Unë po flas për truallin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Zoti Mima, a mund t'jua jap përgjigjen? Ajo çfarë tha kryetari i bashkisë, që të jem e saktë, ka të bëjë me ndërtesën. Sot ndërtesa aktuale, sipas këtij dokumenti, është 1126 metra. Kjo është ndërtesa në pronësi me një sipërfaqe 5522 metra katrorë. Propozimi që na ka ardhur në projekt bëhet fjalë për një ndërtesë me 9 mijë metra katrorë, ndërkohë ajo që unë po them është se sipërfaqja prej 5522,7 do të jetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ilir Beqaj - Më falni, por dua t'jua shpjegoj!

Hipoteka e Teatrit në fund të procesit do të thotë: sipërfaqe truall 5522,7 metra dhe 9 mijë metra ndërtesë. Pra, në qoftë se tani thuhet 5522...

Eduard Shalsi - Kjo është shumë e qartë dhe nuk e kuptoj pse u nervozuat? Zoti Mima, bëri një pyetje normale dhe tha: sipërfaqja...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka rëndësi për ty, por është në të drejtën e tij që të dyshojë dhe të bëri një pyetje normale: a do të jetë kjo sipërfaqe?

Zoti Beqaj dhe zoti Lorenc, ju tërheq vërejtje!

Kalojmë në diskutimet për procedurë, sepse i kam mbajtur shënim emrat e diskutantëve.

Zonja ministre, jam shumë i shqetësuar për të ditur se kur do të mbyllet Teatri, sepse përbën rrezik nëse shfaqjet do të bëhen atje?

Gjatë kohës që ne kemi diskutuar projektligjin, gjatë muajve të fundit, unë kam parë dy shfaqje në Teatrin Kombëtar. Herën e dytë që kam shkuar u shqetësua të gjithë familjarisht dhe ishim në dilemë nëse duhej apo jo të futeshim brenda, pasi pamë relacionin, i cili ishte i frikshëm. Në fakt, unë kërkoj një përgjigje: a do të mbyllet, apo jo, Teatri? A mund të lejohen më shfaqjet atje në atë gjendje që është Teatri?

Mirela Kumbaro - Në fakt, pas relacionit dhe pas të gjitha prononcimeve të bëra nga Instituti i Ndërtimeve, ne po presim edhe një dokument të fundit zyrtar, ekspertizën e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Në vitin 2015 ka pasur një ekspertizë nga Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, ku ata kanë dhënë alarmin, por ne po presim një ekspertizë më të thelluar. Sipas të gjitha deklarimeve publike, të bëra nga drejtori i zjarrfikësve, sigurisht

parametrat e sigurisë ose pasigurisë në atë masë do të çojnë drejt mbylljes së Teatrit. Besoj se përgjigjen më të saktë për këtë do ta merrni kur të vini sonte në prezantimin me inspektorin e skenës.

Eduard Shalsi – Unë insistoј për një përgjigje urgjente.

Atëherë, fjalën e ka kërkuar zonja Ulqinaku.

Izmira Ulqinaku – Unë kam disa pyetje, pavarësisht se këto pyetje i kam bërë edhe te komisioni tjetër, por nuk mora asnjë përgjigje.

Teatri Kombëtar, për të gjithë ata që nuk e dinë, është ndërtuar në vitin 1939 nga firma “Pater Costruzioni Edili Speciali”, Milano. Të njëjtët arkitektë që kanë ndërtuar Teatrin Kombëtar kanë ndërtuar edhe godinën e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe atë të Kryeministrit, si edhe disa objekte të tjera. Pyetja ime është: si ka mundësi që arritet të restauronit sallat me fibra karboni në Kryeministri, po ashtu restauruat dhe shtuat një kat në Ministrinë e Zhvillimit Urban, objekte, të cilat ishin në të njëjtat kushte si Teatri, dhe nuk po arrini të rikonstruktioni Teatrin?

Eduard Shalsi – Zonja Ulqinaku, a mund t’i bëni të gjitha pyetjet dhe më pas zonja ministre t’u japë përgjigje?

Vazhdoni, ju lutem!

Izmira Ulqinaku – Në këtë godinë është vënë guri i artit tonë skenik. Meqenëse, sipas jush, Teatri nuk paska vlera arkitektonike, a nuk mjafton kjo për ta shpallur atë objekt të trashëgimisë kulturore historike?

Pyetja tjetër ka atë bëjë me tokën që i përket Teatrit. Ndërtimet bëhen në bazë të planit të përgjithshëm vendor dhe rregulloreve që u përkasin. Plani i përgjithshëm vendor përcakton se kush ka të drejtë të ndërtojë, llojin e ndërtimit, funksionin që do të kryejë, intensiteti i ndërtimit, koeficientin e shfrytëzimit e kështu me radhë. Pse zona ku ndodhet Teatri është lënë në PDV? Pse plani i detajuar vendor firmoset nga PKT-ja?

Pse këtë tokë, kaq të rëndësishme, në zemër të Tiranës, e kanë në dorë kryehajdutët? Pse është shpallur projekti i Teatrit “projekt zhvillimi me kushte”? Zhvillimi me kushte është kur ndërtimi e kalon intensitetin dhe sipërfaqen e lejuar nga plani i përgjithshëm vendor, në mënyrë që privati të vendosë në dispozicion të bashkisë pjesë nga trualli i tij. Ku është toka e privatit, që

do të vendoset në dispozicion të bashkisë? Sa është sipërfaqja e “Teatrit Fusha”, që do të ndërtohet, domethënë njolla dhe sipërfaqja e ndërtimit?!

(Diskutime pa mikrofon)

Po, por ai nuk është Teatri Kombëtar, është “Teatri Fusha”.

Eduard Shalsi – Kam vetëm një sugjerim për ju deputetët e rinj. Në qoftë se doni të vendosni epitete të tilla, thjesht mendojini, por, të paktën, në këtë komision, mund t’i kurseni. Të gjithë të ftuarit, por edhe ne, jemi të interesuar dhe duam të marrim përgjigje për të gjitha pyetjet tuaja. Ndaj, duhet që të shmangni epitetet, sepse rezervojnë të drejtën edhe të ftuarit të përgjigjen dhe ne humbasim interesin për pjesën racionale të pyetjeve tuaja, të cilën unë nuk mund ta mohoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këta janë deputetë të rinj, ndaj nuk janë familjarizuar ende me procedurat. Unë dua thjesht të sjell në vëmendjen tuaj që të jeni më të kujdesshëm në këtë pjesë.

Zonja ministre, mund të përgjigjeni.

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Lidhur me pyetjen tuaj të parë mund të them se nuk është kriter se cila shoqëri apo kompani e ka ndërtuar Teatrin në vitin 1938, nëse objekti duhet të marrë statusin pasuri kulturore apo jo, por janë cilësitë e vetë objektit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e kam shënuar si pyetje, ndaj më lini ta mbaroj. Nëse e kam gabim jam gati të përgjigjem përsëri. Ju thatë se e njëjta shoqëri e asaj periudhe ka ndërtuar edhe disa objekte të tjera. Unë dua t’ju them se pikërisht këtë informacion nuk e keni të saktë, sepse nuk është e njëjta cilësi, nuk është e njëjta teknologji, nuk është e njëjta arkitekturë dhe nuk janë të njëjtat parametra si për objektet e ministrive dhe të godinës që ju përmendët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është e njëjta cilësi dhe këtë nuk e them as unë dhe as ju, unë nuk e di profesionin tuaj, por imi nuk është, megjithatë një shpjegim më të detajuar mund ta japë drejtori i Institutit të Ndërtimit. Lidhur me faktin që është shpallur apo jo monument kulture, përsëri dua t’ju them se ky objekt nuk e ka pasur asnjëherë këtë status, as para viteve ‘90 dhe as pas viteve ‘90. Unë u

shpreha lidhur me ekspertët, sepse, me gjithë dëshirën që mund të kemi, nuk e përcaktojmë dot ne të dyja këtë gjë. Pra, janë ekspertët e institucioneve përkatëse që shprehen për këtë gjë.

Unë kam këtu një dokument të vitit 2004, ku një grup shumë i nderuar ekspertësh të Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, të cilët vazhdojnë të jenë personalitete të fushës, kanë nxjerrë një listë shqyrtimi për disa objekte dhe për Teatrin Kombëtar janë shprehur: “ndërtesë pa vlerë”. Ky është dokumenti origjinal, të cilin mund t’jua vë dispozicion, i datës 18.05.2004. Në vitin 2007 ministri i Kulturës ka nxjerrë një listë me 108 objekte të shpallura me status monument kulture, duke përfshirë ish-ministritë, Galerinë Kombëtare e të tjerë, ku sërish Teatri Kombëtar, jo në sajë të vullnetit të ministrit, por sipas relacioneve dhe shpjegimeve që bënë ekspertët, nuk shpallet monument kulture. Kjo për sa i përket statusit monument kulture.

Me lejen tuaj dua t’ia lë fjalën drejtorit të Institutit të Ndërtimit për të shpjeguar me më detaje pyetjen tuaj të parë dhe më pas nënkryetarit të Bashkisë lidhur me planin e përditshëm vendor dhe PDV-në, që, në fakt, nuk e ka vetëm ky objekt, por e ka çdo objekt, sepse është me detyrim.

Agron Hysenlliu - Faleminderit!

Objektet në fjalë kanë karakteristika të ndryshme dhe objekti për të cilin ne po flasim, Teatri Kombëtar, është një ngrehinë në letër. Objektet e tjera janë “ngrehina të shtangëta”, siç i quajmë ne, të cilat kanë skelaturë dhe mund të mbajnë riparime në tokë, kurse objekti Teatri Kombëtar nuk mban riparime. Kështu që ky objekt ndryshon totalisht nga karakteri i objekteve të tjera, ndaj në të nuk mund të kryhen riparime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo nuk bëhet fjalë për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

Ju lutem, më lejoni që t’jua shpjegoj!

Ai është një objekt i shtangët i përbërë nga mure dhe soleta betonarme, kurse kjo nuk ka mure, ka disa kolloncina si bandierë dhe soletat e tyre janë prej dërrase.

(Diskutime pa mikrofon)

Eduard Shalsi – A ka mundësi të mos e ndërprisni!

Agron Hysenlliu – Kështu që ky objekt nuk mban riparime dhe në gjuhën tonë teknike quhet “ngrehinë e lehtë”, sepse nuk llogaritet për specifitete, por llogaritet vetëm për erën dhe

borën. Duke qenë e tillë nuk mund të rikonstruktohet, por në të mund të bëhen vetëm riparime të pjesshme, jo riparime kapitale. Shoqata e Arkitektëve ka bërë një dëgjese me mua dhe 70 arkitektë dhe rikonstukturë kanë rënë dakord me atë që ne kemi paraqitur.

Eduard Shalsi – Është shumë e qartë. A mbaruan përgjigjet për pyetjet?

Arbjan Mazniku – Për sa u përket planeve të detajuara vendore apo intensiteteve të mundshme zhvillimore, ky Kuvend i nderuar, nëpërmjet dy akteve, ligjit “Për pushtetin vendor” dhe ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” ka caktuar, në mënyrë sistematike, se si planifikohen me intensitet zhvillimor dhe se cilat janë entet që kanë të drejtë të marrim vendimmarrje lidhur me këto çështje. Kjo do të thotë se plani urbanistik i qytetit të Tiranës është miratuar nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, gjithashtu është miratuar edhe nga Këshilli Kombëtar i Territorit.

Ligji “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në Republikën e Shqipërisë” planifikon, në mënyrë të qartë, mekanizmat se si vendosen intensitetet e mundshme zhvillimore të Shqipërisë. Kjo do të thotë se në këtë fazë, kur ne ende jemi duke u strukturuar, nuk mund të flasim për intensitete zhvillimore, por po flasim për një negociim të mundshëm midis një partneri privat, i cili ka sjellë një propozim, dhe nesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Zonja Ulqinaku, ju i drejtuat pyetje, atëherë lëreni të përgjigjet!

Arbjan Mazniku - Pas procesit të negociimit do të jetë detyra jonë që të kryejmë të gjitha procedurat ligjore për të filluar studimin.

Eduard Shalsi – Zoti Bitri, a keni ndonjë propozim për komisionin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ulqinaku, ju keni plotësisht të drejtë! Unë kam vetëm një problem me ju, sepse ju bëtë disa pyetje dhe nuk po u jepni mundësinë atyre të përgjigjen. Nëse përgjigjet për ju nuk do të jenë bindëse, atëherë mund të bëni komente. E vetmja gjë që po kërkoj, vendoseni veten në vendin tim, është që të mbaj rendin e këtij komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull!

Atëherë, falënderoj ministrinë!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Mirupafshim!

MBYLLET MBLEDHJA

